

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 34464 / 26
Nr. i fq. / Br. st. - 2 -
Data: / Datum: 31.07.2026

VUSHTERI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 121/26 31/07/2026

Bazuar në nenin 12 në lidhje me nenin 53 paragrafi “2” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë **30 korrik 2026**, pasi ka shqyrtuar gjendjen lidhur me disa publikime dhe afishe në rrejtët sociale që nxisin urrejtje fetare në Komunë e Vushtrisë, miraton këtë:

DEKLARATË

Ne, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, në cilësinë e përfaqësuesve të qytetarëve, përmes grupeve kuvendare, shprehim shqetësimin tonë për çdo publikim, deklaratë apo përmbajtje në rrjetet sociale dhe në hapësirën publike që përmban gjuhë të urrejtjes, nxit përçarje mbi baza fetare, etnike apo të tjera, ose mund të interpretohet si thirrje për dhunë.

Ky reagim vjen pas publikimeve të vazhdueshme, nga një qytetar i fshatit Maxhunaj, shkrime këto me përmbajtje të urrejtjes ndërfetare, nxitjes dhe thirrjeve për dhunë.

Liria e shprehjes është e drejtë themelore e garantuar me ligj, por ajo nuk mund të përdoret si justifikim për përhapjen e urrejtjes, diskriminimit apo nxitjes së dhunës. Shoqëria jonë është ndërtuar mbi vlerat e bashkëjetesës, respektit të ndërsjellë, tolerancës dhe harmonisë ndërmjet të gjithë qytetarëve. Çdo veprim që cenon këto vlera dëmton kohezionin shoqëror dhe interesin publik.

Prandaj:

1. Dënojmë fuqishëm çdo formë të gjuhës së urrejtjes, nxitjes së përçarjes dhe çdo deklaratë apo veprim që mund të nxisë intolerancë ose dhunë.
2. Ftojme organet kompetente të Republikës së Kosovës që, në përputhje me kompetencat e tyre, të trajtojnë çdo rast kur ekziston dyshimi për shkelje të ligjit dhe të ndërmarrin veprimet e nevojshme.

3. U bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve, institucioneve, organizatave dhe mediave që të kontribuojnë në ruajtjen e një klime të respektit, dialogut dhe bashkëjetesës, duke promovuar gjuhën e përgjegjshme dhe vlerat demokratike.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë mbetet i përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dinjitetit të çdo qytetari dhe forcimin e harmonisë e unitetit në komunitetin tonë.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

30 korrik 2026



Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit